



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.392/6 prot.

Datë 17.02.2026

V E N D I M
Nr. 266/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “EM-EA Construction” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-71378-12-09-2025, me objekt: “Krijimi i shtegut turistik “Liçeni i Degës – Liçeni i Çestijes – Liçeni Merhojës dhe Kompleks i Dumrea Eco Park në Marinëz”, me fond limit 16,116,156.02 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.

Ankimues: Operatori ekonomik “EM-EA Construction” SHPK, me NIPT M56827701I, dhe adresë Peshkopi Diber Peshkopi, Rruga Dali Ndeu, ndertesa nr 18.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Belsh
Adresa: Rruga “Haziz Dervishi”, Belsh.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021, “Për miratimin e rregullave ‘Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik’”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 5.11.2020, “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.12.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur”, me REF-71378-12-09-2025, me objekt: “Krijimi i shtegut turistik “Liqenii Degës – Liqenii Çestijes – Liqeni Merhojës dhe Kompleks i Dumrea Eco Park në Marinëz”, me fond limit 16,116,156.02 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.

II.2. Në datën 09.01.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 23.01.2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

2 N	9,119,126	lekë	Skualifikuar
BOE 3 EL KONSTRUKSION& Llazo	10 360 919.35	lekë	Skualifikuar
BAJRAMI N.	11,571,407.28	lekë	Kualifikuar
BONUS	11.414.462,68	lekë	Kualifikuar
EM-EA CONSTRUCTION	9,999,999.11	lekë	Skualifikuar
ERGI	9,176,557.37	lekë	Skualifikuar
FLED	9 589 167.13	lekë	Skualifikuar
ISOBAR CONSTRUCTION	11.029.528,40	lekë	Kualifikuar
KOLOSEU	12,971,859.1	lekë	Skualifikuar
MAKARESH	10 608 477	lekë	Kualifikuar
MODESTE	10 138 911	lekë	Skualifikuar
NIKA	10.475.757,96	lekë	Kualifikuar
Sark	12 253 177	lekë	Skualifikuar
T&J CONSTRUCTION	10,096,317.5	lekë	Skualifikuar
VELLEZERIT HYSA	10.156.104,88	lekë	Kualifikuar
XHASt	13.363.518,70	lekë	Kualifikuar

II.4. Në datën 02.02.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraparak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Në datën 06.02.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6307 dhe me nr. protokolli 392/2026, datë 06.02.2026, e operatorit ekonomik “EM-EA Construction” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “EM-EA Construction” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprahe” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e

zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 392/1, datë 09.02.2026.

II.7. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, në datën 10.02.2026, autoriteti kontraktor, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr.405 prot., datë 10.02.2026, protokolluar me tonën me nr.392/2 prot., datë 10.02.2026, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik, “EM-EA Construction ” SHPK. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur refuzimin e saj.

II.8. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, me shkresën nr.406 prot., datë 10.02.2026, protokolluar me tonën me nr.392/3 prot., datë 12.02.2026, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e prokurimit objekt ankimi, si dhe vendimin e KSHA nr.392/2 prot., datë 10.02.2026, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik, “EM-EA Construction ” SHPK.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente në Sistemin e ankesave elektronike nga operatorë ekonomikë në cilësinë e subjektit të interesuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “EM-EA Construction ” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, me arsyen se: *Duke u bazuar te ligji nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“ I Ndryshuar dhe VKM nr.285 ,datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik“ operatori ekonomik nuk permbush piken 2.3.1 ku shprehet se: Ne piken 2.3.1 Përvoja e suksesshme në realizimin e të paktën:*

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht : 8 058 078.01lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 32 232 0312.04 leke pa TVSH. Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Për sa më sipër Operatori ekonomik OE EM-EA CONSTRUCTION me Nipt M56827701I ka ngarkuar ne SPE 1 (nje) punë të ngjashme dhe nga zërat e mbledhura ne kete pune ne baze te situacionit operatori ekonomik nuk e përmbush vlerën qe kërkohet sipas kriterëve te kualifikimit. Pra është kërkuar që për kualifikimin e operatorit të paraqitet pikat e sipërpermendura, ndërkohë që OE nuk e ka përmbushur siç është kërkuar ne DST dhe dispozitat ligjore te prokurimit. Mosparaqitja e tyre përbën kusht për skualifikim”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën Shtojca 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, 2.3.**Aftësitë teknike dhe profesionale**, pika 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.1 Përvojë e suksesshmenërealizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëmnënjëvlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **8 058 078.01** lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesëviteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.
- b. Punë të ngjashmederi ne nje kufi kuvleramonetaretotale e punëve të kryera, e marrësëbashkugjatëpesëviteve të fundit, është jo më të vogël se dyfishiivlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **32 232 312.04** lekepa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- Për kontrata të realizuara me entepublike, Operatoriekonomikduhet të paraqesëdokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Certifikaten e marrjes ne dorezim te perkohshem/perfundimtar.
- Për kontrata të realizuara me sektorinprivat, Operatoriekonomikduhet të paraqesëdokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore.
 - Situacion përfundimtar
 - Akt kolaudimi

-

Ne rast te BOE, Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim: *Per punet e ngjashme te realizuarasi BOE krahas dokumenteve te mesiperme duhet te paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku percaktohet ndarja e zerave te punimeve ndermjet paleve, ndersa per punet e ngjashme te realizuara si nenkontraktor duhet te paraqitet edhe kontrata e nenkontraktimit ku percaktohen zerat e punimeve dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit.*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “EM-EA Construction” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

1. Kontratë sipërmarrje datë 03.10.2025 me objekt “*Punime rikonstruksion1 dhe sistemimi i sheshit te godines me nr. pas 985/95, z. k 1066, Paskuqan*”, lidhur midis shoqërisë “Sireta 2 F” SHPK dhe operatorit ekonomik "EM-EA Construction" SHPK, me vlerë të realizuar 16,050,430 lekë pa tvsh, shoqëruar me formular vlerësimi, akt-kolaudimi, situacion përfundimtar dhe faturën tatimore nr.21/2025, datë 22.12.2025.

III.1.3. Në nenin 77, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.1.4. Në nenin 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga

operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6.Referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërën prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, ku operatori ekonomik duhet të provojë, se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “EM-EA Construction” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, operatori ekonomik ankimues, ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.1.2 të këtij vendimi.

KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomike ankimues, kontratës së dorëzuar nga ankimuesi, situacionit përfundimtar të punimeve, në zbatim të kontratës së sipërcituar të realizuar prej tij, faturës tatimore të shitjes, parë kjo në rrafshin krahasimor me preventivin dhe relacionin e specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, komponenti kohë (ku Komisioni për këtë komponent do të marrë në konsideratë kontrata të cilat janë brenda afatit kohor 5 vjeçar nga data e njoftimit të kontratës, 10.12.2025), komponenti vlerë (lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet), si dhe komponentit natyrë e ngjashme (i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratës së dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues me objektin e prokurimit, nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës, por edhe nga zërat e preventivave të tyre.

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik, ku të shënohen vlera, afati

i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar, se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërimit të dokumentacionit është brenda periudhës pesëvjeçare, sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave.

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të kontratës së sipërcituar, (me objekt *“Punime rikonstruksioni dhe sistemimi i sheshit te godines me nr. pas 985/95, z. k 1066, Paskuqan*), duke nisur që nga objekti i saj, përshkrimi i punimeve në situacion apo faturë tatimore si pjesë përbërëse e kontratave, si dhe afati i realizimit të saj (data 03.12.2025), të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik ankimues “EM-EA Construction” SHPK për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kjo kontratë i përmbush të tre komponentët, pra si komponentin vlefshmëri (brenda afatit pesëvjeçar nga data 10.12.2025), si komponentin ngjashmëri (që ka objekt apo zëra të ngjashëm në situacion dhe fatura si zërat në preventivin e objektit të prokurimit) dhe si komponentin e vlerës së realizuar. Komisioni Prokurimit Publik, nga përlllogaritja e zërave të ngjashëm të kontratës objekt prokurimi me kontratën e realizuar, e më konkretisht: Punime gërmimi dhe prishje, Punime shtresa dhe nënshtresa, Punime betoni dhe betoni të armuar, Punime sinjalistike (referuar situacionit dhe faturës së paraqitura nga operatori ekonomik EM-EA Construction” SHPK, vëren se vlera e tyre është xxxx lekë, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet a) *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në njëvlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 8 058 078.01 lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesëviteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Sa më lart, nga verifikimi i punës së realizuar dhe dokumentacionit shoqërues të saj, i paraqitur si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet, se operatori ekonomik ankimues ka kryer punime të ngjashme me zërat në preventivin e hartuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi, duke përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve të tenderit. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë, se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, por edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, nisur nga arsyeja e skualifikimit, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e

proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik, “EM-EA Construction” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-71378-12-09-2025, me objekt: “Krijimi i shtegut turistik “Liqenii Degës – Liqenii Çestijes – Liqeni Merhojës dhe Kompleksi i Dumrea Eco Park në Marinëz”, me fond limit 16,116,156.02 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.
 2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “EM-EA Construction” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “EM-EA Construction” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

